



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 20.07.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONTROLLIN SHTETËROR TË TRANSFERIMEVE
NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE USHTARAKE DHE TË ARTIKUJVE E
TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË DYFISHTË”.**

Drejtuar: Seancës Plenare.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjet e datës 12.07.2018, 17.07.2018 dhe 19.07.2018 në parim, nën për nen dhe në tërësi projektligjin “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Vullnet Sinaj.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim vjen si propozim i Ministrisë së Mbrojtjes në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për kontrollin shtetëror të importit, eksportit të mallrave ushtarake, mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, ka si qëllim vendosjen e kontrollit shtetëror mbi transferimin ndërkombëtar të mallrave të ushtarake, artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, për të siguruar mbrojtjen e interesave kombëtare të Republikës së Shqipërisë, sigurinë dhe politikën e

jashtme, kredibilitetin ndërkombëtar të saj dhe garantimin e respektimit të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në këtë fushë.

III. OBJEKTIVAT E PROJEKTLIGJIT

Objektivat e këtij projektligji janë :

- Përshtatja e dispozitave themelore të kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare, në përputhje me rregulloret e BE-së, si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare dhe traktatet ku Shqipëria është palë.
- Qartësim i përkufizimit të sistemit të licencimit dhe i autorizimit që parashikon ky ligj si dhe harmonizimi me rregulloret e BE-së.
- Evedentim i dallimeve thelbësore midis konceptit të mallrave ushtarake dhe mallrave të teknologjive me përdorim të dyfishtë, duke e ndarë mënyrën e licencimit të këtyre kategorive në dy kapituj të veçantë.
- Futja e koncepteve të reja, duke ndryshuar dhe duke përputhur me rregulloren e BE-së terminologjinë, licencimin, programin e përputhshmërisë etj.

IV. ÇËSHTJET KRYESORE QË TRAJON PROJEKTLIGJI

Në nenin 1, të këtij projektligji, janë përcaktuar përkufizimet e koncepteve bazë të ligjit, duke vendosur terma të cilat nuk ishin në ligjin e vjetër dhe që janë në përputhje me terminologjinë e Bashkimit Evropian.

Në veprimtaritë e kontrolluara është përfshirë edhe transshipi dhe ndërmjetësimi i transferimeve ndërkombëtare.

Përkufizimi i eksportit, eksportuesit, deklaratës së eksportit, transitit, ndërmjetësimit, mallrave të kontrolluara (me përdorim të dyfishtë), asistencës teknike, kategorive të licencave, janë bërë në përputhje të plotë me rregulloren nr.428/2008 të Bashkimit Evropian.

Në nenin 9, të këtij projektligji, është sanksionuar procesi i shkëmbimit të të dhënave në procesin e kontrollit shtetëror të eksporteve, si proces me rëndësi të veçantë në vendimmarrjen e transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake, artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Në nenin 10, të këtij projektligji, referuar listës së mallrave, objekt i kontrollit shtetëror të eksporteve, janë përfshirë në objektin e kontrollit dhe të licencimit mallrat e përfshira në listë, mallrat të cilat nuk janë të përfshira në listë, por destinacioni i tyre përfundimtar është përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, vendi i destinacionit përfundimtar është një vend nën embargo ose mund të përdoren për vepra terroriste.

Në nenin 11, të projektligjit, janë parashikuar rastet e kontrollit shtetëror në transferimet ndërkombëtare edhe për mallrat dhe artikujt të cilët nuk janë të listuar në listën e kontrollit, por nëse ekziston informacioni se këto mallra do të përdoren për qëllimet e përcaktuara në këtë nen, këto mallra do t'i nënshtrohen procedurës së kontrollit dhe të licencimit.

Ky quhet kontroll gjithëpërfshirës dhe është në përputhje me rregulloren nr.428/2009 të BE-së dhe ka si qëllim kontrollin e mallrave për rastet e sipërcituara.

Në nenin 12, të këtij projektligji, janë përcaktuar kriteret, në bazë të analizës të të cilave bëhet vlerësimi i riskut në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara. Në këto kriteret janë listuar kriteret e parashikuara në qëndrimin e përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian 2008/944/CFSP, të datës 8 dhjetor 2008, i cili përcakton rregullat e përbashkëta për administrimin e kontrollit të eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake, ndërsa në nenin 13 janë listuar disa kriteret të tjera mbi pastërtinë e figurës së subjektit të përfshirë në këto transferime

Në ndryshim nga ligji i mëparshëm, i cili parashikonte dispozita të njëjta për mallrat ushtarake dhe ato me përdorim të dyfishtë, ky projektligj ka dy kapituj të veçantë ku parashikon regjimin e kontrollit për mallrat ushtarake dhe regjimin e kontrollit për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.

Për mallrat ushtarake është parashikuar detyrimi për regjistrim i tyre dhe pajisja me certifikatë regjistrimi, afati i certifikatës së regjistrimit 3 vjet, si dhe rastet e refuzimit, e të çregjistrimit të subjekteve të reregjistruara.

Për të forcuar masat e sigurisë gjatë transportit të këtyre mallrave është parashikuar në nenin 19 që transporti i mallrave në rrugë tokësore dhe transporti e transiti i tyre në rrugë tokësore e detare të bëhen me eskortë të armatosur, sipas dispozitave të ligjeve në fuqi.

Në kapitullin IV, “Artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë”, kategoritë e licencave të cilat lëshohen janë: Licencat me një përdorim, licencat globale, si dhe licencat e përgjithshme

Neni 25 përcakton mënyrën e organizimit dhe të mbajtjes nga subjektet e programit të përputhshmërisë, për të përfituar licencat globale dhe ato të përgjithshme. Ky program kontrollohet dhe certifikohet nga AKSHE-ja, në bazë të kriterëve të këtij neni.

Në kreun V të projektligjit përcaktohen procedurat e licencimit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe pas analizave të kriterëve të vlerësimit të riskut, si dhe afatet e shqyrtimit të aplikimeve. Për çdo procedurë transferimi është parashikuar afati ligjor i shqyrtimit të dokumentacionit, afati i marrjes së mendimeve nga institucionet e tjera shtetërore. Nëse informacioni shtesë që i kërkohet subjektit, nuk paraqitet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e kërkesës drejtuar subjekteve, aplikimi konsiderohet i refuzuar.

Në nenet 29, 30, 31, të këtij ligji, janë parashikuar rastet e refuzimit, pezullimit shfuqizimit dhe anulimit të licencave dhe certifikatave. Në të gjitha këto nene është vendosur dhe një dispozitë ku parashikohet përjashtimi i shtetit shqiptar nga përgjegjësitë ligjore dhe dëmet e mundshme të shkaktuara si rezultat i veprimeve juridike të mësipërme.

Në kreun VI është parashikuar një risi në këtë ligj, i cili është neni 36 “Kontrolli doganor”, ku përcaktohet mënyra e bashkëpunimit të AKSHE-së me autoritetin doganor mbi informimin për licencat e lëshuara dhe vendimet e marra, si dhe kompetencën e autoritetit doganor për të pezulluar procesin e transferimit dhe bllokuar mallrat, parashikim ky i cili i mungonte legjislacionit të mëparshëm, duke u gjendur përpara vështirësive në situata të tilla, ku asnjë organ nuk kishte të parashikuar kompetencën për të marrë këtë vendim.

Në nenet 37 dhe 38, të ligjit, janë parashikuar detyrimet e subjekteve për mbajtjen e të dhënave në transferimet ndërkombëtare, si dhe detyrimi i tyre për raportim dhe informim në AKSHE për licencat e lëshuara.

Në kreun VII, në nenin 39 përcaktohen format e inspektimit, sipas ligjit për inspektimin, si dhe mundësia e AKSHE-së për të inspektuar ambientet dhe dokumentacionin mbi të cilin bazohet transferimi ndërkombëtar.

Në nenin 41 është bërë listimi i kundërvajtjeve administrative, sipas shkallës së gravitetit si dhe janë parashikuar masat e gjobave.

V. DISKUTIME NË KOMISIONIN PËR SIGURINË KOMBËTARE

Për prezantimin e projektligjit “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” ishte prezent Zëvendësministri i Mbrojtjes Z. Petro Koçi, së bashku me përfaqësues të kësaj ministrie si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision u vlerësua ndërmjarrja e kësaj nisme ligjore duke evidentuar rëndësinë që ka në krijimin e një sistemi efikas të kontrollit shtetëror (të importit, eksportit, transitit, transshipit, brokering,) në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake, mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, kontroll i cili ushtrohet para, gjatë dhe në zbatim të detyrimeve të cilat rrjedhin nga veprimtaria e subjekteve të licencuara në këtë fushë.

Gjatë diskutimeve, nga anëtarët e komisionit theksi u vu tek risitë që sjell ky projektligj, i cili ka ndryshuar thelbësisht ligjin e mëparshëm, duke futur koncepte të reja, si dhe duke ndryshuar dhe duke përputhur me rregulloren e BE-së terminologjinë, licencimin, programin e përputhshmërisë etj

Duke qënë se ligji i mëparshëm nuk bënte dallim mbi ndryshimet në konceptin e mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, të cilat pavarësisht ngjashmërive në kontrollin e tyre kanë disa dallime thelbësore, këto dallime janë reflektuar në projektligjin e ri duke e ndarë mënyrën e licencimit të këtyre kategorive në dy kapituj të veçantë.

Nga anëtarët e opozitës, pati diskutime rreth parashikimit që për çdo vendim heqjeje, shfuqizimi të licencave apo autorizimeve, për çdo dëm eventuale që sillet në veprimtarinë normale të subjekteve private, subjekti privat nuk ka të drejtë ta kërkojë dëmshpërblim. Ky pretendim u sqaruar nga Zëvendësministri i Mbrojtjes, i cili theksoi se bëhet fjalë për raste tepër të veçanta, pra kur merren veprime, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e interesave kombëtare dhe garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare të shtetit dhe jo për një veprimtari të zakonshme.

Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, duke marrë parasysh edhe propozimet e ardhura nga Komisioni për Integrimin Europian, propozoi riformulimet si me poshtë :

RIFORMULIME NEN PËR NEN :

Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon :

“Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- *Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 428/2009, datë 5 maj 2009 “Mbi vendosjen e një rregjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetesimit dhe tranzitit të **mallrave me përdorim të dyfishtë**”, e ndryshuar. Numri CELEX 32009R0428, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 134, datë 29.05.2009, **faqe 1-269**”.*

Në nenin 2, pika 5, gërma “a” termi “Eksportues”, të riformulohet si vijon:

“5. “Eksportues” është:

- a) çdo person fizik ose juridik, **ose partneritet**, në emër të të cilit paraqitet deklarata doganore e eksportit ose personi që në kohën kur pranohet deklarata ka kontratën me marrësin e ngarkesës në vendin e huaj dhe ka autoritetin që të vendosë për dërgimin e mallit jashtë territorit doganor të Shqipërisë. Nëse nuk është lidhur asnjë kontratë eksporti apo nëse mbajtësi i kontratës nuk vepron në emër të vetë atij, eksportues është personi që ka autoritetin të vendosë dërgimin e mallit jashtë territorit doganor të Shqipërisë;”

Në nenin 8 të projektligjit, u sugjerua që **pika 2** e tij, të riformulohet si më poshtë:

“2. Ky detyrim është gjatë dhe pas përfundimit të detyrës sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Në nenin 9 të projektligjit, u propozua që në **pikën 4** fjala “përcakton” të zëvendësohet me fjalën “miraton”, konkretisht :

*“Këshilli i Ministrave **miraton** me vendim, organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statusin e AKSHE-së dhe afatet, mënyrën dhe procedurën për shkëmbimin e informacionit dhe marrjes së mendimit me institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara”*

Në nenin 13 të projektligjit, gërma “b” të riformulohet si më poshtë :

*“b) subjekti aplikues është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, sipas përcaktimeve të këtij ligji apo sipas dispozitave të tjera ligjore, që lidhen me **rendin kushtetues** dhe sigurinë kombëtare ose është në procedim penal apo dënuar nga një gjykatë e huaj me vendim të formës së prerë për shkeljen e legjislacionit për kontrollet e transferimeve ndërkombëtare;*

Në nenin 39 të projektligjit, në pikë **“4”** pas fjalës “njofton” të shtohet fjala “menjëherë”, konkretisht :

*4. “Kur ka të dhëna të mjaftueshme që tregojnë se po bëhen tentativa për të kryer një veprë penale ose kur ajo është kryer në fakt nga ndonjë subjekt dhe nëse në të janë të përfshira edhe mallra, që janë objekt i kontrollit shtetëror të eksporteve, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve njofton **menjëherë** autoritetet penale.”*

Neni 43 i projektligjit të riformulohet duke u ndarë në dy pika si dhe pas togfjalëshit “mbrojtjes së interesave” të shtohet fjala “të sigurisë”, konkretisht:

“1.Vendimi i marrë nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për të vendosur gjoba, pezulluar, revokuar licencën, certifikatën apo autorizimin apo çregjistrim të një subjekti të përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake mund të ankimohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

2.Shteti shqiptar nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj një subjekti për humbjet e shkaktuara për shkak të pezullimit apo të shfuqizimit të licencës, autorizimit, certifikatës dhe garancisë shtetërore, nëse

këto veprime janë ndërmarrë për qëllime të mbrojtjes së interesave të sigurisë kombëtare dhe garantimit të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare të shtetit.”

Në nenin 48 të projektligjit, **pika “1”** të zgjatet afati nga 3 (tre) në 6 (gjashtë) muaj duke u riformuluar si më poshtë :

“1. Këshilli i Ministrave brenda 6 (gjashtë) muajve miraton aktet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 9, në pikën 1, të nenit 10, në pikën 2, të nenit 20, në pikën 8, të nenit 35, dhe në pikën 1, të nenit 46, të këtij ligji. “

Gjithashtu, për teknikë legislative u ra dakort që në të gjithë dispozitat e projektligjit termi “AKSHE” të shkruhet i plotë, pra *Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksportev*.

VI. PËRFUNDIME

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji ,me shumicën e votave, miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi sipas amendimeve të propozuara nga vetë komisioni por edhe nga Komisioni për Integrimin European në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, duke ja kaluar për miratim seancës plenare.

RELATOR

KRYETARE

VULLNET SINAJ

ERMONELA VALIKAJ (FELAJ)